

2068
2503.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË
Dhoma Civile
K/SEKRETARIA

Bulevardi "Gjergj Fishta" Tirana

www.gjykatatirana.gov.al

Nr. Prot.

Tiranë, më 20.03.2024

Lënda: Dërgim vendimi

QËNDRËS KOMBËTARE TË BISNESIT (QKB)
TIRANË

Bashkëlidhur kësaj shkrese, pas marrjes formë të prerë ju dërgojmë vendim me Nr. 8832 Akti, datë 22.02.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm Tirana, ku është vendosur për hapjen e procedures se falimentimit të shoqërisë Shoqërisë "Denis -05" sh.p.k.

K/SEKRETARE

Mimoza TAFA






REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Numri i regjistrat themeltar 8832
Data e regjistrimit 10.08.2023

Data e vendimit 22.02.2024

VENDIM
“Në emër të Republikës”

Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë nga gjyqtari i vetëm:

Dritan CAKA

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Luljeta Kazia, në Tiranë, sot më 22.02.2024, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen tregtare që i përket:

Kërkuese: **Shoqëria “Denis 05” sh.p.k.**, me NIPT K51518029B, me seli në adresën: Rruga “Hamid Shijaku”, Pallati nr. 22, Hyrja 2, Apartamenti 7, Tiranë, me administrator z. Hajredin Ukperaj.

Objekti:

- Kërkësë për fillimin e procedurës së falimentimit, me likujdim, të shoqërisë tregtare “Denis-05” sh.p.k.
- Caktimin e Administratorit të Falimentimit.
- Vendosjen masave të sigurisë mbi të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe mbi të drejtat e debitorit.

Baza ligjore: Nenet 7, 13, 14, 15, 17 të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016 “Për falimentimin”; Nenet 41, 42, 153, 334 të K. Pr. Civile.

Gjkata, pasi analizoi në dhomë këshillimi pretendimet e palës kërkuese, si dhe aktet që i bashkëlidhen kërkësës,

VËREN

1. Referuar ekstraktit të regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se shoqëria “Denis-05” sh.p.k. është themeluar më datë 31.01.2005, me seli në adresën: Rruga “Hamid Shijaku”, Pallati nr. 22, Hyrja 2, Apartamenti 7, Tiranë, me ortak të vetëm dhe administrator z. Hajredin Ukperaj, ndërkohë që objekti i veprimitarisë së saj tregtare është:

“*Subjekt ndërtues për seline administrative. Ndërtime, rikonstruksione, punime komunale shërbim ndërtime hidrotekniche, kanalizime, ujësjella, elektrike, rrugë e sistemime, transportim mallrash e pasagjerësh brenda e jashtë vendit, tregtim të artikujve të ndryshem industrialë e ushqimore. Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve inerte. etj.*”

Ndërkohë, kapitali i shoqërisë “Denis-05” sh.p.k. rezulton të jetë në masën 61.000.000 lekë, në një kuotë të vetme.



2. Nëpërmjet kërkesës objekt shqyrtimi shoqëria "Denis-05" sh.p.k. ka kërkuar që nga ana e gjykatës të hapen procedurat e falimentimit të saj, me likuidim, me pretendimin se ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese.

Po kështu, shoqëria në fjalë ka kërkuar caktimin e një administratori të falimentimit, si dhe vendosjen e masave të sigurisë mbi të gjitha pasuritë e saj të luajtshme dhe të paluajtshme.

Konkretisht, pala kërkuese ka parashtruar argumentat që vijojnë:

- Bazuar në "Raportin e paaftësisë likuiduese" të paraqitur nga administratori i saj, shoqëria "Denis-05" sh.p.k. ndodhet në vështirësi të mëdha për likuiditete.
- Në total, sipas këtij raporti, shuma e detyrimeve për t'u likuiduar është në vlerën 755,212,306 lekë. Ky detyrim krijon paaftësi paguese për shoqërinë, duke rënduar situatën ekonomiko-financiare.
- Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 110/2016 "Për Falimentimin", duke qenë se është evidentuar brenda afatit ligor (60 ditë) paaftësia paguese, shoqëria i është drejtuar gjykatës për fillimin e procedurave dhe likuidimin e kreditorëve, nëpërmjet procedurës së falimentit me likuidim.
- Shoqëria aktualisht ka detyrime të maturuara, duke rezultuar në paaftësi paguese dhe në këto kushte konsideron se është e nevojshme likuidimi i të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes së të ardhurave nëpërmjet procedurës së falimentimit.
- Gjithashtu, bëhet e nevojshme që nga ana e gjykatës të urdhërohet marrja e masave të sigurisë mbi të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe mbi të drejtat e debitorit shoqëria "Denis-05" sh.p.k., pasi aktualisht, në referim të dokumentacionit provues bashkëlidhur kësaj kërkese, kjo shoqëri ka shumë detyrime për të cilat nuk ka aftësi paguese dhe, në kushtet kur gjendja e paaftësisë paguese është reale, ekziston rreziku real i cënimit të pasurive të shoqërisë nga ana e kreditorëve. Kjo do të sillte pasoja edhe me të rënda duke rënduar gjendjen e shoqërisë.

3. Pas paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurave të falimentimit nga ana e shoqërisë "Denis-05" sh.p.k., gjykata vlerësoi të nevojshme që, në zbatim të kritereve të parashikuara në nenin 19 të ligjit 110/2016 "Për falimentimin", përpara marrjes së një vendimi për pranimin apo refuzimin e kërkesës, të merrte mendimin e një eksperti të kësaj fushe, me qëllimin për të hetuar rreth pretendimit të kësaj shoqërie për plotësimin e kushteve të parashikuara në ligjin në fjalë për hapjen e procedurave të falimentimit.

Për këtë qëllim nga ana e gjykatës u caktua **znj. Lindita Kikino**, eksperte kontabël e miratuar dhe administrotore falimentimi me nr. 12 license, të cilës iu kërkua që të realizojë detyrat si më poshtë vijon:

1. *Të verifikojë nëse ekzistojnë shkaqe për të filluar procedurën e falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k.;*
2. *Të verifikojë nëse pasuritë e debitorit janë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e procedurave të falimentimit;*
3. *Të mbikqyrë veprimitaritë e debitorit, duke përcaktuar nëse ushtron apo jo veprimitari tregtare aktualisht;*
4. *Të jepë një opinion nëse është e nevojshme të vendosen masa të përkohshme për të siguruar pasuritë e debitorit "Denis-05" sh.p.k.*

Për realizimin e detyrave të ngarkuara ekspertes iu kërkua që të bazohet në dokumentacionin e dosjes gjyqësore, në kqyrjen e dokumentave financiare pranë shoqërisë "Denis-05" sh.p.k., si dhe pranë të tretëve.

Pas marrjes së detyrave ekspertja Lindita Kikino ka paraqitur aktin e ekspertimit të datës 30.11.2023, ku rezulton të ketë arritur në përfundimet që vijojnë:

- a) **Përgjigja e pyetjes nr. 1:** Shoqëria "Denis-05" sh.p.k. ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese dhe bazuar në nenin 14 të Ligjit nr. 110/2016 "Për falimentimin", ekzistojnë kushtet për hapjen e procedurës së falimentimit për këtë shoqëri.
- b) **Përgjigja e pyetjes nr. 2:** Shoqëria disponon pasuri të cilat mbulojnë kostot e procedurave të falimentimit. Pavareisht se shoqëria nuk disponon likuiditete, ajo ka aktive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kerkesa të arkëtueshme. Në këto kushte debitori ka mundësi të mbulojë shpenzimet e procedurës së falimentimit. Gjithashtu, në kërkësen drejtuar gjykatës për çeljen e procedurave të falimentit pala debitore ka paraqitur "Deklaratën" ku konfirmohet gjendja e mjeteve monetare në arkë e shoqërisë më datë 14.07.2023, në shurnën 3.000.000 lekë.
- c) **Përgjigja e pyetjes nr. 3:** Referuar dokumentacionit të ndodhur në dosjen gjyqësore, në vlerësimin e ekspertes nuk është e nevojshme që të merren masa për të mbikëqyrur veprimtarinë e debitorit, deri në momentin që gjykata të shprehet me vendim për fillimin ose jo të procedurës së falimentimit.
- d) **Përgjigje e pyetjes nr. 4:** Referuar të gjithë informacionit të publikuar në faqen zyrtare të QKB-së, në ekstraktin historik rezulton se ndaj shoqërisë janë vendosur disa urdhra sekuestro. Duke qënë se janë në fuqi disa urdhra përmbarimore, të cilët mund të shtohen në të ardhmen, bazuar kjo në situatën financiare të debitorit, rreziku i ekzekutimit të pasurive është i lartë. Si rrjedhojë, ekspertja ka gjykuar të nevojshme vendosjen e masave të përkohshme, me qëllim sigurimin e pasurive të debitorit shoqëria "Denis-05" sh.p.k. Marrja e një mase të tillë është në interesin më të lartë përsa i përket situates aktuale në të cilën ndodhet debitori.

5. Gjykata, pasi analizoi kërkësen dhe provat që i bashkëlidhen asaj, si dhe bazuar në përfundimet që ka arritur ekspertja administratore falimentimi e licensuar znj. Lindita Kikino, si më lart, vlerëson se ekzistojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 110/2016 "Për falimentimin" që të hapen procedurat e falimentimit për shoqërinë "Denis-05" sh.p.k.

5.1 Kështu, duke iu referuar ligjit në fjalë rezulton se procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo të mbingarkesës me borxhe.

Konkrektisht, në nenin 2 të këtij ligji parashikohet se:

"Procedura e falimentimit synon të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit përmes riorganizimit të aktivitetit ose përmes likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes të të ardhurave."

Pra, kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse vlerësohet se shitja e pasurive të tij do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani riorganizimi (shëndetësimi) për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

Sipas kritereve të ligjit, fillimi i procedurës së falimentimit realizohet vetëm nëse konstatohet ekzistencë e dy shkaqeve konkrete, që janë:

- a) gjendje e paaftësisë paguese e subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim ose/dhe
- b) mbingarkesa e subjektit me borxhe.

Legitimimin aktiv për fillimin e procedurave gjyqësore të falimentimit e gëzojnë kreditori, debitori si dhe organet tatimore, në rast konstatimi të humbjeve në bilancotë subjektit për një periudhe fiskale 3-vjeçare.

Konkrektisht, në nenin 13 të ligjit nr. 110/2016 parashikohet se:

"Fillimi i procedurës të falimentimit mund të kërkohet nga debitori ose kreditorët në formë të shkruar dhe në përputhje me kërkësat e përcaktuara në këtë ligj."



Sipas nenit 14 të të njëjtë ligj, në rastin kur kërkesa për hapjen e procedurave të falimentimit paraqitet nga vet subjekti debitor, ky i fundit duhet të vërtetojë se është në kushtet e paaftësisë paguese aktuale ose në një të ardhme të afërt, si dhe t'i bashkëlidhë kërkesës një sërë dokumentash në mbështetje të këtij pretendimi.

Konkretnisht, në këtë dispozitë ligjore parashikohet se:

"1. Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit mbështetet në paaftësinë paguese ekzistuese të debitorit ose në paaftësinë paguese në një-të ardhme të afërt. Së bashku me kërkesën, debitori paraqet edhe dokumentacionin dhe informacionin në vijim:

a) raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit;

b) ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin;

c) bilancin dhe pasqyrat financiare për tri vitet e fundit të aktivitetit të debitorit. Nëse debitori ka ushtruar veprimitari për një periudhë më të shkurtër kohe, për aq sa kjo periudhë është;

c) listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshire:

i) vlerën e çdo pasurie në momentin e blerjes;

ii) vlerën aktuale të tregut në rast se këto pasuri kanë qenë objekt i rivlerësimit;

iii) vendndodhjen e pasurive; dhe/ose

iv) të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe

v) nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci, ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së sigruar;

d) listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;

dh) listë të kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshire emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve;

e) listë të kreditorëve që janë persona juridikë, përfshire emrat e tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, nëse është rasti, si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve;

ë) listë të debitorëve të debitorit, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshire emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë;

f) listë të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë, si paditës ose i paditur.

2. Dokumentet, sipas pikës 1, të këtij nenit, duhet të janë originaire, të nënshkruara dhe/ose të vulosura në çdo fajqe dhe të shoqëruara nga një deklaratë, ku shprehet se përbajtja e dokumenteve shoqëruese është e plotë dhe e saktë. Nëse ka arsyë të bazuara se përbajtja e dokumenteve nuk është e plotë ose e saktë, duhet të përcaktohet shprehimi i tekstin e deklaratës. (...)"

5.2 Referuar sa më lart, gjykata konstaton së pari se pala kërkuese shoqëria "Denis-05" sh.p.k. legjitimohet të paraqesë këtë kërkesë, pasi ka cilësinë e debitorit në procedurën e falimentimit, pra ka një interes me karakter pasuror, duke qenë se bëhet fjalë për pasurinë e vet kësaj shoqërie.

Po kështu, vendimi për paraqitjen e kërkesës për hapjen e procedurave të falimentimit është marrë nga organi kompetent i shoqërisë, që është pikërisht ortaku i vetëm i saj.

Nga ana tjeter, bashkëlidhur kërkesës për hapjen e procedurave të falimentimit janë paraqitur të gjithë dokumentat dhe informacioni i parashikuar në nenin 14 të ligjit nr. 110/2016, i cituar më lart.

Ndërkohë, siç është parashtruar më lart, ekzistanca e shkakut për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. është konfirmuar edhe nga akti i ekspertimit i kryer paraprakisht me kërkesë të gjykatës nga ekspertja e kësaj fushe znj. Lindita Kikino, ku ëhstë theksuar se, nga analiza e dokumentacionit rezulton që shoqëria në fjalë është në paaftësi paguese afatshkurtër.

Konkretisht, në përbajtje të aktit të ekspertimit është theksuar se:

"Sipas analizës financiare (analizë horizontale, analizë vertikale dhe analizë e koeficientëve) rezulton se shoqëria ka përkeqësuar treguesit e saj financiar. Shoqëria është e ngarkuar me detyrime afatshkurtra, ka një situatë të vështirë të aftësive paguese, duke qenë se aktivet e saj afatshkurtra nuk mund të konsiderohen qarkulluese. Detyrimet e paguaeshme janë shtuar, si dhe është ulur marzhi i fitimit."

Në rrethanat e mësipërme, duke qenë se vërtetohet ekzistenca e kushteve për hapjen e procedurave të falimentimit të parashikuara nga dispozitat e ligjit nr. 110/2016, sikurse janë paftësia paguese dhe mbingarkesa me borxha, gjykata vlerëson se duhet të vendoset pranimi i kërkësës dhe hapja më datë 22.02.2024, ora 15.30, të procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k., duke emëruar si administratore falimenti Znj. Lindita Kikino.

5.3 Me hapjen e procedurave të falimentimit të gjithë kreditorët e shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. duhet të paraqesin pretendimet e tyre pranë administratores falimentimit, brenda 45 diteve nga shpallja e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Mbledhja për raportim e kreditorëve të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. do të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Mbledhja për verifikim e kreditorëve të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. do të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve të tyre.

5.4. Në zbatim të kritereve të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 110/2016 "Për falimentimin", përfundim i afatit të depozitimit të pretendimeve:

- Publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. t'i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. t'i dërgohet Agjencisë Shtëtërore të Kadastrës, me qëllim njoftimin e të gjitha Drejtoreve Vendore të ASHK dhe kryerjen e veprimeve përkatëse.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. t'i dergohet të gjitha bankave të nivelit të dytë që veprojnë në Republikën e Shqipërisë.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. t'i dergohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k., t'i dërgohet Autoritetit Rrugor Shqiptar.
- Publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridikzonit të Përgjithshëm Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet administratores së falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. znj. Lindita Kikino, e cila bazuar në kriteret e ligjit nr. 110/2016 "Për falimentimin", ngarkohet edhe me kryerjen e njoftimeve dhe shpalljeve publike si më lart.

Shpenzimet në lidhje me këto veprime procedurale i ngarkohen masës së falimentimit.

6. Së fundit, bazuar në nenin 106 të K. Pr. Civile, shpenzimet gjyqësore, që përbëhen nga taksa mbi aktet, shpenzimet për ekspert dhe shpenzimet për njoftime, i ngarkohen palës kërkuese.

Për këto arsyе



Gjykata, bazuar në nenet 126, 306-31) të K. Pr. Civile, si dhe në ligjin nr. 110/2016
“Për falimentimin”,

VENDOSI


1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Denis-05” sh.p.k.
2. Hapjen në orën 15:30, të datës 22.02.2024, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Denis-05” sh.p.k., me administrator z. Hajredin Ukpërraj, me seli në adresën: Rruga “Hamid Shijaku”, Pallati nr. 22, Hyrja 2, Apartamenti 7, Tiranë.
3. Emërimin si administratore të falimentimit për shoqërinë “Denis-05” sh.p.k. të znj. Lindita Kikino, e regjistruar në listën e ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, me nr. rendor 12, me adresë: Njësia Bashkiake nr. 9, Rruga “Jordan Misja”, Pallati Sara-El, Shkalla 1, Apartamenti 2.
4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Denis-05” sh.p.k. të paraqesin pranë administratore së falimentimit pretendimet e tyre, brenda 45 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi në QKB.
5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Denis-05” sh.p.k. të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.
6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit shoqëria “Denis-05” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe shlyerjnë ato administratores së falimentimit znj. Lindita Kikino.
7. Mbledhja për raportim e kreditorëve të shoqërisë “Denis-05” sh.p.k. të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
8. Mbledhja për verifikim e kreditorëve të shoqërisë “Denis-05” sh.p.k. të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.
9. Urdhërohet publikimi i shkurtimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridikzionit të Përgjithshëm Tiranë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në Fletoren Zyrtare.
10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Denis-05” sh.p.k. t’i njoftohet administratores se falimentimit znj. Lindita Kikino.
11. Një kopje e shkurtimit të vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Denis-05” sh.p.k. t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim njoftimin e të gjitha Drejtoreve Vendore të ASHK dhe kryerjen e veprimeve në përputhje me kriteret e ligjit nr. 110/2016 “Për falimentimin”.
12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Denis-05” sh.p.k. t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k., t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. t'i dërgohet Autoritetit Rugor Shqiptar.
16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. t'i dërgohet Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Denis-05" sh.p.k. t'i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.
18. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës kërkuese.
19. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksonit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më 22.02.2024

SEKRETARE

 - Luljeta KAZIA -

GJYQTAR

 - Dritan CAKA -

1. Tarife	Gjyqësore	200			1		200
2. Shpenzime për njoftime		150					150

Vendimi mori formë të prerë pasi
 nuk u ankimua më dt 12.03.2024

VERTETOHET NJESI TIRANË më dt 18.03.2024

ME ORIGJINALIN
 K / SEKRETARE
MIMOZA TAFA

K / SEKRETAR
MIMOZA TAFA

